

V E N D I M
Nr. 59 Date 03.06. 2008

PER NJE NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.11, DATË 23.06.2006 “PER DHENIEN E LICENSAVE PER AKTIVITETIN E PRODHIMIT, SHPERNDARJES, FURNIZIMIT, IMPORTIT DHE EKSPORTIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE SHOQERISE KESH SH.A”

Në mbështetje të neneve 9, dhe 13 pika 1, germa ç, të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, pikes 2, paragrafi 9, te Modelit te Tregut te Energjise Elektrike te miratuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 338 date 19.03.2008, dhe neneve 121 dhe 128 te Ligjit nr.8485 date 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative te Republikes se Shqiperise”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 03.06.2008, mbasi shqyrtoi propozimin per ndryshimin e Vendimit te Bordit te Komisionereve Nr.11 date 23.06.2006 “Per dhenien e licensave per aktivitetin e prodhimit, shperndarjes, furnizimit, importit dhe eksportit te energjise elektrike shoqerise KESH sh.a” dhe konstatoi se:


- Modeli i tregut te energjise elektrike parashikon si pjestar te tregut te energjise elektrike furnizuesin publik me shumice i cili do te funksionojë si nje njesi e KESH sh.a e ndare funksionalisht dhe financiarisht,
- Kesh sh.a ka aplikuar per percaktimin e tarifes se furnizuesit publik me shumice per gjashte mujorin e dyte te vitit 2008,
- ERE percakton tarifate e energjise per aktivitet e licensuara

Vendosi

1. Në vendimin nr.11 datë 23.06.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Per dhenien e licensave per aktivitetin e prodhimit, shperndarjes,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I
SEKTORIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE
Bordi i Komisionereve



furnizimit, importit dhe eksportit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a” në pikën I, shtohet pika 6 me përmbajtjen :

6 – aktivitetin e furnizimit publik me shumicë

2.Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë KESH sh.a për vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s
Bujar Nepravishta



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I
SEKTORIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE
Bordi i Komisionereve

